



STIKK

SHOQATA PËR TEKNOLOGJI TË INFORMACIONIT DHE TË KOMUNIKIMIT TË KOSOVËS
KOSOVO ASSOCIATION OF INFORMATION AND COMMUNICATION TECHNOLOGY

RAPORT VJETOR

2012

**Përgatitur për Mbledhjen e Kuvendit të STIKK
Janar, 2013**

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
Publikimet gjate vitit 2012	5
Mbledhjet e Bordit	5
Stafi i STIKK.....	5
Anëtarët e STIKK.....	5
Te hyrat dhe shpenzimet.....	5
Auditimi i financave te STIKK.....	5
AKTIVITETET	6
Mbledhja e 4 e Kuvendit te STIKK	6
Objektivi 1. Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përsheptuar të sektorit të TIK.....	6
Pakoja fiskale.....	6
Projekti DFID “ Perkraheja e Zhvillimit te Sektorit Privat ne Kosove”	6
Workshop “Experience Exchange Group of Business Associations”	7
Platforma per Avokim dhe Lobim	7
Workshop “ Kosovo Business Association Group”	7
Workshop “Kosovo Business Association Forum”	7
Workshop “Technical Assistance to Further Development of Kosovo’s Trade Policy”	7
Pjesëmarrja ne grupin punues për shtytjet dhe pengesat ne inovacionet e bizneseve kosovare	8
Forumi për inovacion	8
Grupi punues për Inovacionin	8
Konferenca MTI – OECD	8
Takim ne Zv.Ministrin e Punëve te Jashtme te Kosovës	8
Takim punues në Tryezën Tematike nr. 4 për fushën e Industrisë dhe NVM-ve / MTI.....	8
Tryeze e rrumbullaket për “Eksport te Shërbimeve” e organizuar nga USAID YEP / ICK / STIKK	9
Strategjia kombëtare e inovacionit /MASHT.....	9
Mëngjesi me ekspertë: udhërrëfyesi për t’i shtuar në maksimum investimet tuaja në ICT / VERSO	9
Objektivi 2: Zhvillimi i burimeve njerëzore në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK-ut	9
Prezantimi publik i ICT Call 9 prej FP7	9
ICT-KOSEU mbështet Kosovën ne sektor te TIK-ut.....	10
Training Workshop for Kosovo Multipliers on FP7/ICT	10
Trajnimi motivues për femra.....	11
Panairi i Karrierës	11
STIKK vazhdon përkrahjen e sektorit të TIK në implementimin e standardeve (ISO 27001)	11
Organizimi i trajnimit dhe certifikimit për Tester Softuerik	11
Takimi i hulumtuesve nga Kosova me hulumtuesit ndërkombëtar, Varshave	12
Vizite studimore ne Norvegji.....	12
Organizimi i trajnimit dhe certifikimit për ISO 9001	12

ICT KOSEU ofron mundësi për hulumtuesit përmes ueb faqes.....	13
Objektivi 3: Ofrimi i shërbimeve për anëtarë me qëllim të krijimit të mundësive të reja biznesore	13
Innovation Center Kosovo “Business Tuesday”	13
BIZTECH	13
CeBIT 2012	13
Konferenca Kosowwwweb	14
Ngjarja rajonale e TIK ne Tirane (Regional IT Event in Tirana)	14
Pjesëmarrja ne CompuTEX, Taipei	14
B2B Kosove – Bullgari	14
Dita Mbarëkombëtare e TIK	15
Organizimi i Konferencës SFK’12	15
ICT Summit Euroasia-Bilisim Zirvesi’12	15
Konferenca KosICT	16
B2B ne kuadër te konferencës KosICT	16
B2B Takimi me VISMA	16
Business Tuesday	16
STIKK përmes Wominnovation përkrahë punën e grave	16
Pyetësori për Kompanitë – Growth Program	17
Pjesëmarrja ne ngjarjet e Microsoft.....	17
Microsoft Vizija Event	17
Microsoft Day Albania.....	17
Objektivi 4: Krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme të STIKK-ut	17
Zhvendosja e STIKK ne objektin e Innovation Centre Kosovo	17
Ceremonia e hapjes se Innovation Centre Kosovo.....	17
PMP Prep Course	18
Trajnimi për menaxhim te projekteve.....	18
Përdorimi i softuerit Quick Books për menaxhimin e financave	18
Kursi përgatitës për Teknik te Kontabilitetit	18
Trajnimi 1 ne 1	18
Trajnimi për Monitorim dhe Evaluim	18
Auditimi i financave te STIKK.....	18
STIKK ne Innovation Centre Kosovo	19
Workshop “Bussiness Development Services”	19
Trajnimi ne MS Project.....	19
Publikimet	19
Depërtimi dhe përdorimi i internetit në Kosovë	19
Standardizimi ne sektorin e TIK: Pengese apo përparësi?	19
Analiza e Prokurimit Publik për TIK për periudhën Janar 2010 - Qershor 2012	20
Raporti i Auditimit Teknologjik ne kuadër te Projektit te KE/FP7: ICTKOSEU	20
Stafi i STIKK.....	20

Anëtarët e STIKK.....	20
TE HYRAT DHE SHPENZIMET	21
Te hyrat	21
Shpenzimet	21
Mbledhjet e Bordit.....	22
Me 30 Janar, 2012, ne mbledhjen e njëzete te rregullt, ku janë diskutuar çështjet ne vijim:	22
Me 21 Shkurt, 2012 ne mbledhjen e njëzetënjetë (e jashtëzakonshme), ku janë diskutuar çështjet ne vijim:	22
Me 19 Prill, 2012, ne mbledhjen e njëzete e dyte (e jashtëzakonshme), ku janë diskutuar çështjet ne vijim:	22
Me 10 Maj, 2012 ne mbledhjen e njëzetetretë, ku janë diskutuar çështjet ne vijim:	23
Me 03 Gusht, 2012, ne mbledhjen e njëzetekatërtë, ku janë diskutuar çështjet ne vijim:	23
Me 06 Shtator, 2012 është mbajtur mbledhja e njëzetepestë(e jashtëzakonshme), ku janë diskutuar çështjet ne vijim:	23
Me 18 tetor, 2012, ne mbledhjen e njëzetegjashtë, ku janë diskutuar çështjet ne vijim:	23
Përmbyllje	25



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Me 28 mars, u mbajt Kuvendi i katërt Vjetor i anëtarëve të STIKK në hotel Emerald. Qëllimi i mbajtjes së këtij Kuvendi ishte prezantimi i aktiviteteve dhe të arriturave të STIKK gjatë periudhës njëvjeçare si dhe prezantimi dhe aprovimi i planit vjetor të aktiviteteve dhe buxheti për vitin 2012. Poashtu, u prezantua edhe hulumtimi "Penetrimi dhe përdorimi i internetit në Kosovë"- i pari i këtij lloji.

Gjatë periudhës njëvjeçare, një nga aktivitetet kryesore ka qenë angazhimi i shoqatës rreth realizimit të Objektivit të parë -**Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm legjislativ dhe politik për zhvillim të përsheptuar të sektorit të TIK** në kuadër të së cilit është synuar ndryshimi i Ligjit mbi TVSH dhe Doganat për importin e pajisjeve të IT. Ky ligj është tani në Parlamentin e Kosovës, e ka kaluar dëgjimin e parë dhe iu është dërguar komisioneve relevante parlamentare për aprovim. Aprovimi i tij final nga ana e deputeteve të kuvendit pritet të bëhet në tremujorin e parë të vitit 2013.

Përveç kësaj, STIKK mori pjesë në seminarin e organizuar nga DFID në kuadër të projektit të mbështetjes së zhvillimit të sektorit privat në Kosovë; mori pjesë në takimin e grupit punës për Inovacion i organizuar nga OECD; luajti një rol aktiv në Forumin për Inovacion, organizuar nga OECD; ishte pjesëmarrëse në konferencën e organizuar nga agjencioni për NVM pranë MTI-së me temën "Nisma për zhvillimin e ndërmarrjeve dhe Lehtësirave Inovative në Ballkanin Perëndimor", organizoi disa takime me shoqatat e ndryshme të biznesit dhe odave ekonomike në Kosovë, si dhe në bashkëpunim me D4D zhvilloi platformën për lobim dhe avokim.

Lidhur me objektivin e dytë- **Zhvillimi i burimeve njerëzore në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK**, STIKK realizoi 2 trajnime për hulumtuesit kosovar, dërgoi 8 persona në dy "brokerage event" (5 në CEBIT dhe 3 në Varshavë); ka organizuar një panair të karrierës; tri trajnime profesionale me 36 pjesëmarrës, prej të cilëve 29 u certifikuan (ISO 9001, ISO 27001 dhe software tester); si dhe një trajnim motivues për femra në sektorin e TIK.

Gjatë periudhës raportuese është punuar edhe për realizimin e Objektivit të tretë- Ofrimi i shërbimeve për anëtarë me qëllim të krijimit të mundësive të reja biznesore përmes pjesëmarrjes së STIKK dhe kompanive anëtare në panairin më të madh të TIK (CeBIT 2011), pjesëmarrjes në CompuTEX në Taipei, bashkeorganizimin e panairit BIZTECH, bashkeorganizimin e konferencave Kosowwwb dhe SFK'12; organizimin e konferencës rajonale KosiCT; organizimin e takimeve B2B Kosovë- Bullgari në Sofje, gjatë konferencës KosiCT dhe në Prishtinë me kompanitë norvegjeze; organizimit të Ditës Mbarëkombëtare të TIK në Prishtinë; pjesëmarrjes në ngjarjet e Microsoftit në Shkup dhe në Tiranë; Pjesëmarrjes në ICT Summit Euroasia në Turqi; pjesëmarrjes në ngjarjen rajonale të TIK në Tiranë si dhe pjesëmarrjes aktive në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Innovation Centre Kosovo.

Sa i përket objektivit të katërt- **Krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme**, STIKK ka ndërruar lokacionin dhe tani gjendet në objektin e ICK. Zhvendosja e STIKK në këtë objekt, ofron hapësirë me të madhe për Stafin e STIKK si dhe për trajnime të ndryshme që STIKK organizon për Anëtarët e saj. Vete prezenca fizike e STIKK në një objekt të tillë ofron mundësi të shumta zhvillimi, rrjetëzimi dhe ndikimi pozitiv tek donatorët dhe vendimmarrësit. Pas punës gati dyvjeçare për themelimin dhe funksionalizimin e Innovation Centre Kosovo, STIKK ka nënshkruar dy marrëveshje me Athene, njëra në vlerë mujore prej 4,166.00 euro (prej marsit 2012) dhe e dyta në vlerë mujore prej 3,333.00 euro (prej shtatorit 2012).

Përveç kësaj, stafi i STIKK ka marrë pjesë në 7 trajnime me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve të tyre.

Nga 1 janari i këtij viti, STIKK ka filluar aplikimin e softuerit Quick Books për menaxhimin e financave. Ky softuer është donacion i anëtarit të STIKK, Melita and partners, e cila kompani poashtu ka mbajtur trajnimin e stafit administrativ dhe financiar mbi përdorimin e këtij programi.

Lidhur me realizimin e objektivit të pestë- **Mbështetja e anëtarëve për ushtrimin e përgjegjësisë shoqërore të sektorit të TIK**, janë ndërmarrë aktivitete të angazhimit të anëtarëve të STIKK neper komisione vlerësuese në kuadër të ICK si dhe në Bordin e ICK.

Publikimet gjate vitit 2012

Depërtimi dhe përdorimi i internetit në Kosovë [Depërtimi dhe përdorimi i internetit në Kosovë](#)

Standardizimi ne sektorin e TIK: Pengese apo përparësi? [Standardization in the ICT Sector](#)

Analiza e Prokurimit Publik për TIK për periudhën Janar 2010 - Qershor 2012 [ICT Public Procurement](#)

Raporti i Auditimit Teknologjik ne kuadër te Projektit te KE/FP7: ICTKOSU www.ictkoseu.eu

Mbledhjet e Bordit

Gjate vitit 2012 u mbajtën gjithsej shtatë mbledhje të Bordit të STIKK, katër të rregullta (30 janar, 10 maj, 03 Gusht dhe 18 Tetor) dhe tri të jashtëzakonshme (21 shkurt, 19 prill dhe 6 shtator).

Stafi i STIKK

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2012, janë bërë disa ndryshime në stafin e STIKK:

Për shkak të vëllimit të shtuar të punëve, më 1 prill pas procedurave të selektimit, është pranuar në punë Znj. Argjira Mexhuani si Asistente për Administratë dhe Financa (fillimisht ka qene praktikante për 3 muaj) dhe me 1 tetor Z. Valon Canhasi si menaxher i projektit Growth. Ne cilësinë e praktikantit është pranuar Znj. Vesa Batalli me 8 nëntor.

Ne vitin 2012, STIKK numëron 7 punëtorë me orar te plote dhe 1 praktikante. Gjate implementimit te aktiviteve, STIKK ka angazhuar 8 konsulent te jashtëm.

Anëtarët e STIKK

Me 2012, janë anëtarësuar 8 Kompani te reja: Trokit, King ICT, Altima, Ion Coders, Informatika Computers, PTK, Next SEO, Phogen.

Pas lansimit te shërbimit te ri për anëtarësimin e anëtarëve individual, gjate këtij viti janë anëtarësuar 23 Profesionist/e edhe 35 Student/e.

Po ashtu tani kemi si anëtarë bashkëpunues edhe 3 kolegje private: Iliria, Universum edhe Riinvest.

Pas revidimeve te kompanive anëtare, tani STIKK numëron 123 anëtarë (60 kompani, 23 profesionist, 35 studente dhe 5 institucione arsimore). Gjate vitit 2012, anëtarësinë e kane paguar gjithsej 39 kompani anëtarë ose 65% nga numri i gjithëmbarshtëm, ndërsa sa i përket anëtarëve individual pagesa e anëtarësisë do te filloje ne vitin 2013.

Te hyrat dhe shpenzimet

Gjatë vitit 2012, të hyrat e STIKK ishin 254,412.02€ (79% me shume krahasuar me 142,152.84€ te vitit 2011), ndërsa shpenzimet kapin shumën prej 241,723.20€ (krahasuar me 148,674.60 € te vitit 2011)

Auditimi i financave te STIKK

Gjate kësaj periudhe raportuese kompania audituese e pavaur "AB Audit", e përzgjedhur nga anëtarët e STIKK ne Mbledhjen e fundit te Kuvendit, ka bere auditimin e të gjitha transaksioneve dhe procedurave financiare te STIKK për periudhën 1 Janar - 31 Dhjetor 2011. Raporti ka treguar rregullsi në të gjitha aspektet e menaxhimit të mjeteve.

AKTIVITETET

Me qëllim të realizimit të objektivave të përcaktuara në mbledhjen e Kuvendit të STIKK, e të cilat janë të përfshira edhe në Planin Strategjik të STIKK 2011-2013, gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar aktivitetet në vijim:

Mbledhja e 4 e Kuvendit të STIKK

Me 29 Mars 2012, në mjediset e Hotel Emerald në Prishtinë, STIKK organizoi Kuvendin e katërt të rregullt vjetor.

Qëllim i organizimit të këtij Kuvendi ishte prezantimi i punës së shoqatës gjatë vitit 2011, planifikimi i aktiviteteve dhe buxhetit për vitin 2012, si dhe prezantimi i hulumtimit "Depërtimi dhe përdorimi i internetit në Kosovë".

Në Kuvendin e katërt të shoqatës ishin prezent dhe patën fjalim rasti, z. Bernard Nikaj, Këshilltar i Lartë Politik dhe Shef i Kabinetit, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, dhe z. Jan Braathu, Ambasador, Ambasada e Mbretërisë Norvegjeze.

Ambasadori i Mbretërisë Norvegjeze, z. Braathu në fjalimin e tij ndër të tjera theksoi se Shoqata është duke e luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e sektorit të TIK në shtet. "Programi i STIKK për stimulimin e rritjes së sektorit, rritjes së konkurrencës, avokimi për standarde dhe arsimimi në këtë fushë ndikojnë drejt zhvillimit të kapaciteteve dhe potencialeve të sektorit. Kjo është e rëndësishme për kompanitë TIK të Kosovës, dhe poashtu është e rëndësishme për krijimin e vendeve të punës dhe për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të këtij shteti" u shpreh Ambasadori Norvegjez.

Ndërsa z. Nikaj në fjalimin e tij paraqiti gadishmerine e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të përkrahe dhe bashkëpunoj me STIKK-un në aktivitetet e ardhshme.

Pas fjalimeve u prezantuan aktivitetet ndërkombëtare të Shoqatës nga Z. Valon Budima, Nënkryetar i Bordit të STIKK dhe raporti i punës një vjeçare u prezantua nga znj. Vjollca Cavolli, Drejtoreshë Ekzekutive e STIKK.

Në pjesën punuese, Kuvendi i STIKK miratoi Planin e punës dhe buxhetin për vitin 2012 dhe bëri përzgjedhjen e anëtarëve të rinj të Bordit z. Dardan Vokshi - INET, dhe z. Mentor Sahiti - Adaptivit.

Objektivi 1. Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përsheptuar të sektorit të TIK

Pakoja fiskale

Megjithëse në takimin e mbajtur më 5 gusht 2011, Ministri Bedri Hamza premtoi se implementimi i pakos pritet të fillojë po këtë vit (2011) dhe do të implementohet në tërësi gjatë vitit 2012, kjo nuk ndodhi, dhe tani pakoja fiskale gjendet në Parlament, ku po i merr aprovimet nga komisionet e ndryshme relevante për këtë çështje (komisioni i zhvillimit ekonomik, ai i integriteteve evropiane, komisioni i buxhetit etj)

Projekti DFID "Përkrahja e Zhvillimit të Sektorit Privat në Kosovë"

Me 26 Janar 2012, STIKK mori pjesë në një seminar të organizuar nga DFID "Përkrahja e Zhvillimit të Sektorit Privat në Kosovë". Seminari përmbante prezantime në lidhje me të arriturat e projektit dhe prezantime teknike nga ekspertët mbi çështjet kryesore për zhvillim të NVM-ve, strategjinë dhe politikat prioritare të NVM-ve.

Me mbështetje të DFID, STIKK ka angazhuar një konsulent me qëllim të draftimit të 3 dokumente politikash në lidhje me këto çështje.

Çështja e vonësës të pagesës (Late payment issue)

Çështja e prokurimit publik (Varshmëria e çmimit me te ulet si kriter te përzgjedhjes te kompanive me kualitet me te ulet)

Çështja e TVSH-se(Shkallëzimi i TVSH-se)

Këto çështje janë identifikuar nga një pyetësor qe e ka bere STIKK me anëtarët e saj.

Workshop “Experience Exchange Group of Business Associations”

Eksperti Peter Bolton, i angazhuar nga Komisioni Evropian, më 19 Tetor organizoi workshop-in “Experience Exchange Group of Business Associations” e cila u mbajt në zyrë të STIKK. Në këtë workshop u prezantuan çështjet kryesore më të cilat ballafaqohen NVM-të në Kosovë. Pjesëmarrësit në këtë grup morën vendim që të bëjnë një prezantim për qeverinë në mënyrë që t’i adresojnë këto çështje:

- Të bëjmë qeverinë të na dëgjojë
- Legjislacioni- mungesë e konsultimit të mirëfilltë nga ana e qeverisë
- Vështirësitë në qasje në financa
- Trajnimi dhe përkrahja e NVM-ve
- Prokurimi
- Shkallëzimi i TVSH-së.

Platforma per Avokim dhe Lobim

Tryeza e rumbullakët për Platformën “ Avokim dhe Lobim” është organizuar nga STIKK më 2 Nëntor ku ishin të ftuar edhe përfaqësues të shoqërisë civile të “Demokracisë për Zhvillim” (D4D). Pjesëmarrësit u informuan rreth projektit “Let the Real Civil Society Please Stand Up!” e cila u mbështet nga Olof Palme International Center (OPIC), dhe është duke u implementuar nga D4D, i cili mundëson krijimin e marrëdhënieve me deputetët. Qëllimi kryesor i këtij projekti është të ndihmojë shoqatat e anëtarësuar të bëhen më konkurruese si dhe të kenë më tepër ndikim në politikë-bërje.

Gjatë diskutimit u propozua që të hartohet një platformë nga STIKK, që do t’i dërgohej deputetëve të Parlamentit. Kjo platformë do të trajtonte disa nga çështjet e identifikuar si të rëndësishme për sektorin e TIK. Prandaj, STIKK u angazhua rreth këtij propozimi dhe gjatë muajit dhjetor hartoi platformën e cila do iu dërgohet deputetëve të parlamentit gjatë muajit Janar.

Workshop “Kosovo Business Association Group”

Workshop-i “Kosovo Business Association Group” u organizua me 13 Nëntor në zyret e AKB-së. Në këtë workshop është diskutuar për emrin e këtij komuniteti i cili ka ndryshuar nga “Kosovo Business Association Group” në “Kosovo Business Association Forum”. Gjatë këtij takimi gjithashtu janë përcaktuar rregullat dhe procedurat e grupit, janë dhënë propozime për anëtarësime të reja në këtë grup, si dhe është përcaktuar data e takimit të ardhshëm.

Workshop “Kosovo Business Association Forum”

Edhe një takim i shoqatave te biznesit u mbajt me 11 Dhjetor, ne te cilin prapë u munduam qe te bëjmë bashke këto shoqata për një lobim dhe avokim te përbashkët për çështje te përbashkëta te bizneseve te cilat i përfaqësojnë. Ne te njëjtën kohe, STIKK beri një prezantim te përvojës avokuese për përmirësimin e ambientit te te berit biznes ne Kosove.

Workshop “Technical Assistance to Further Development of Kosovo’s Trade Policy”

Ky workshop u mbajt më 13 Dhjetor në zyret e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në kuadër të projektit “Technical Assistance to Further Development of Kosovo’s Trade Policy” e financuar nga Unioni Evropian. Gjatë këtij workshop-i është bërë një prezantim lidhur me Tregtinë e shërbimeve në Kosovë ku si aktorë kryesorë ishte krijimi i bazës së të dhënave për bizneset dhe pjesëmarrësit tjerë.

Ky aktivitet është pjesë e projektit “Asistencë teknike e zhvillimit të mëtutjeshëm të politikës Tregtare të Kosovës” i financuar nga Unioni Evropian.

Pjesëmarrja ne grupin punues për shtytjet dhe pengesat ne inovacionet e bizneseve kosovare

STIKK mori pjese ne grupin punues te organizuar nga "OECD Investment Compact for South East Europe". Ky grup punues është mbajtur ne objektin e ICK-se, ne Prishtine me 04.07.2012. Te pranishëm ishin përfaqësues nga qeveria, shoqëria civile, kompani private etj.

Forumi për inovacion

Ky forum u organizua nga OECD me **25 Shtator** ne Prishtine. Qëllimi i Forumit për Inovacion është qe te bashkohen palët me interes nga ana e sektorit te biznesit, institucionet kërkimore si dhe qeveria për te diskutuar sfidat e sistemit te inovacionit si dhe politikat e nevojshme për ta nxitur inovacionin. Pjesëmarrja ne këtë forum i ka ofruar STIKK-ut qe te kontribuojë ne mënyrë aktive për përpilimin e ardhshëm te strategjisë se inovacionit.

Grupi punues për Inovacionin

STIKK mori pjese ne takimin e grupit punues për Inovacion i organizuar nga "OECD Investment Compact for South East Europe", i cili u mbajt ne zyrën qendrore te OECD-se ne Paris, France me **21 dhe 22 Qershor**.

Qëllimi i takimit ishte qe te shkëmbehen përvojat e vendeve te rajonit ne aspekt te zhvillimit te Inovacionit si dhe te ngriten kapacitetet për zhvillim dhe implementim te politikave efektive. Ne këtë takim morën pjese përfaqësues te Maqedonisë, Serbisë, Malit te zi, Shqipërisë, Kosovës dhe Bosnje e Hercegovinës. Përveç STIKK-ut si përfaqësues te sektorit privat, te gjithë pjesëmarrësit tjerë ishin nga Qeveria dhe Institucionet edukativo-Arsimore.

Konferenca MTI – OECD

Më 17 tetor STIKK ishte pjesëmarrës në konferencën e organizuar nga agjensioni për NVM pranë MTI-së me temën "Nisma për zhvillimin e ndërmarrjeve dhe Lehtësirave Inovative në Ballkanin Perëndimor". Në këtë konferencë u diskutua për pengesat që hasin ndërmarrjet në Kosovë si dhe u prezantua raporti mbi gjendjen e ndërmarrjeve në Kosovë. Të pranishëm ishin përfaqësues të bizneseve si dhe përfaqësues të institucioneve të republikës së Kosovës. OECD ka identifikuar 51 donatorë me buxhet prej 237 Milion Euro dedikuar për ndihmën e ndërmarrjeve në Kosovë. Në këtë takim u propozuan 18 legjislacione nga OECD ndërsa 3 nga to u votuan si më me prioritet.

Në bashkëpunim me bizneset dhe institucionet e Republikës së Kosovës u vendosën këto prioritetet: rritja e gatishmërisë së investimeve të ndërmarrësve , promovimi i specifikave për edukim dhe trajnim profesional të kompanive dhe ndihma për NVM-të që të adaptojnë standardet teknike, në mënyrë që të nxisë rritjen e konkurrencës në eksportet e tyre.

Vegëza: <http://www.telegrafi.com/ekonomi/gasja-ne-financa-sfide-per-ndermarrjet-e-vogla-dhe-te-mesme-46-12787.html>

Takim ne Zv.Ministrin e Punëve te Jashtme te Kosovës

Gjate muajit nëntor STIKK ka zhvilluar takim me zv.Ministrin e Punëve te Jashtme z.Petrit Selimi për te shqyrtuar mundësitë e bashkëpunimit. Z.Selimi premtoi përkrahje ne projektet e STIKK si dhe ne pjesëmarrjen ne panairat internacionale. Ne këtë takim te shkurter u diskutua edhe për angazhimin e STIKK ne strategjinë e diplomacisë digjitale.

Takim punues në Tryezën Tematike nr. 4 për fushën e Industrisë dhe NVM-ve / MTI

Ne këtë takim janë diskutuar sfidat te cilat janë paraqitur ne raportin e përpiluar nga TaskForca për NVM-et dhe industrinë ne përgjithësi. Nga ky takim përfaqësuesi i zyrës se EU-se na njoftuan qe ne TM2/2013 do te fillojnë me asistence teknike dhe financiare për NVM-et, projekt i cili do te implementohet nga IOM.

Tryeze e rrumbullaket për “Eksport të Shërbimeve” e organizuar nga USAID YEP / ICK / STIKK

Ne ICK është organizuar Tryeze e rrumbullaket për fituesit e granteve nga USAID YEP programi, kompani nga fusha e TIK-ut. Ne këtë takim si panelit ishin : Vllaznim Xhiha, Investitor (EYE Kosova), Shkumbin Brestovci – RROTA dhe Fatos Gacaferri, ION Coders. Ne këtë takim u barten përvojat e panelisteve tek përfituesit e granteve për “Eksportimin e shërbimeve” në EU.

Strategjia kombëtare e inovacionit /MASHT

STIKK mori pjese ne tryeze e rrumbullaket mbi strategjinë kombëtare të Inovacionit pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Ne këtë tryeze u diskutua mbi strategjinë kombëtare të inovacionit dhe hapat që duhen të merren. Sugjerimet e STIKK u morën parasysh nga organizatorët në temat që ishin në interes për anëtarë të STIKK si dhe të qendrës ICK. Ne këtë takim u diskutuan këto tema:

- Krijimi i bashkëpunimit ndërministror, dizajnimi dhe zbatimi i politikave të inovacionit
- Ndërtimi i institucioneve më të fuqishme dhe relevante për hulumtim të tregut
- Shtimi i prosperitetit të sektorit të biznesit për të bërë inovacion
- Shtimi i zhvillimit të burimeve njerëzore dhe aftësive të cilat janë më të përshtatura me nevojat e tregut të punës

Mëngjesi me ekspertë: udhërrëfyeshi për t'i shtuar në maksimum investimet tuaja në ICT / VERSO

Kompania anëtare në STIKK, VERSO organizoi një takim me ekspert nga CISCO me temën “Udhërrëfyeshi për t'i shtuar në maksimum investimet tuaja në ICT”

Ne këtë ngjarje STIKK u nderua me fjalim hyrës pranë të pranishmeve që ishin në numër të madh.

Në fjalim u prezantuan të arriturat e STIKK si dhe u ftuan të pranishmit të regjistrohen si IT profesionist në STIKK.

Objektivi 2: Zhvillimi i burimeve njerëzore në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK-ut**Prezantimi publik i ICT Call 9 prej FP7**

Me datën 12 janar 2012 projekti “ICT- KOSEU: Dialogue and Cooperation Between EU & Kosovo in ICT R&D “ i financuar nga programi FP7 ICT i Komisionit Evropian mbajti një prezantim publik lidhur me mundësitë e financimit të projekteve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Kosovë për “ICT Call 9” të FP7.

Kjo ngjarje u organizua nga South East European Research Centre (SEERC, www.seerc.org), koordinator i projektit, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK) dhe Universiteti i Prishtinës (UPR), si dhe partnerët Evropianë si European Business Associates (Itali) dhe URSIT (Bullgari).

Kjo punëtori kishte për qëllim sigurimin e asistencës së nevojshme në leximin e përshkrimit dhe objektivave të “ICT Call 9” dhe informatave se si mund të marrim pjesë në projektet e FP7 si konsorciume me partnerë ndërkombëtarë.

ICT-KOSEU mbështet Kosovën në sektor të TIK-ut

Projekti ICT -KOSEU në vazhden e aktiviteteve të tij, më 23 dhe 24 shkurt 2012 organizoi një trajnim dy ditor, në përpjekje për të gjetur mundësitë për ICT Call 9 të FP7, i cili është i hapur deri më 17 prill të këtij viti.

Ky organizim kishte për qëllim t'i mbledh përfaqësuesit nga bota e akademisë, biznesit, komunitetin e OJQ-ve si dhe profesionistë të tjerë të cilët janë të interesuar që të marrin pjesë me propozimet e tyre për ICT Call 9, ose që janë përfshirë tashmë me propozimet e tyre.

Ky trajnim dyditor ofroi një pasqyrë informacionesh për FP7, informacione të tjera për programin e TIK-ut dhe Call 9 për Kosovë, ndihmoi në të kuptuarit e përmbajtjes së këtij program si dhe formulimin e ideve në funksion të pjesëmarrjes sa më të gjerë me propozime dhe përfshirjen në të.

Përveç kësaj në këtë seminar informues, u shpjeguan edhe rregullat e këtij programi, u jepen udhëzime për plotësimin e formularëve si dhe u prezantuan dhe u diskutuan praktikatat më të mira gjatë këtij trajnimi. Pas përfundimit të seminarit, pjesëmarrësit patën mundësinë për konsultime individuale për idetë mbi projektet e tyre kërkimore.

Kjo ngjarje është organizuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës-STIKK, partnerë të tjerë të projektit ICT-KOSEU si dhe është përkrahur edhe nga URSIT Ltd nga Bullgaria dhe Qendra e Evropës Juglindore për Hulumtime me seli në Selanik, Greqi, që njëkohësisht është edhe koordinator i projektit.

Training Workshop for Kosovo Multipliers on FP7/ICT

Projekti ICT -KOSEU në vazhden e aktiviteteve të tij, me datat **4,5,6 Prill, 2012** në zyrë të STIKK organizoi një trajnim tre ditor i cili do t'u mundësoj profesionistëve të kuptojnë aspektet teknike, financiare dhe procedurale të programit ICT/FP7. Gjatë trajnimit pati informacione të detajuara për programin FP7 dhe pjesët e tij në TIK, pjesëmarrësit po ashtu mësuan se si të përfshihen në propozime, të kërkojnë partner, të shkruajnë dhe dorëzojnë propozime dhe të marrin pjesë në projekte të FP7.

Trajnimit u mbajt nga Z. Ulrich Boes, drejtor i URSIT Ltd., Bullgaria, një prej partnerëve të konzorciumit.

Ky trajnim u dedikua për anëtarë të akademisë, biznese, OJQ dhe autoriteteve publike të Kosovës dhe profesionistëve të ndryshëm, të cilët janë të angazhuar ose të interesuar për të marr pjesë në propozimet e ardhshme të FP7 në TIK. Këta pjesëmarrës do të shërbejnë si bartës (multipliers), të cilët do të transferojnë njohuritë e tyre në persona të ndryshëm.

Si pjesë e projektit ICT- KOSEU STIKK është e angazhuar në përpilimin e një raporti të auditimit teknologjik i cili do të paraqiste gjendjen aktuale dhe prioritetet e zhvillimit dhe hulumtimeve në lëmin e Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit (TIK) në Republikën e Kosovës. Ky raport është i paraparë të përpilohet në konsultim me ekspertët e lëmisë së TIK-ut dhe me palët tjera të interesit.

Si rrjedhojë, STIKK i është drejtuar kompanive anëtarë me një pyetësor me qëllim të marrjes së kontributit të tyre, i cili do ta mundësonte STIKK-un të fitojë njohuri mbi gjendjen e hulumtimeve shkencore apo aplikative në kompanitë Kosovare si dhe informata më specifike rreth bashkëpunimit të tyre me organizata dhe programe tjera të donatorëve, prioritetet e tyre dhe pjesëmarrja eventuale në projektet të BE-së e veçanërisht me projektet e Programit të Kornizës Shtatë të EU-së në lëmin e TIK-ut në vendin tonë. Deri tani kërkesës së STIKK i janë përgjigjur rreth 8 kompani.

Një pyetësor i ngjashëm është hartuar edhe për institucionet hulumtuese dhe arsimore si dhe për qeverinë dhe donatorët. Intervistat me këto palë do të realizohen nga Universiteti i Prishtinës, FIEK dhe MASHT si partnerë vendor të projektit.

Krahas këtij aktiviteti përkritazi me përpilimin e auditimit teknologjik janë angazhuar dy ekspertë të jashtëm të cilët kanë shqyrtuar dokumentet, raportet, hulumtimet e ndryshme dhe legjislacionin për të siguruar një pasqyrë të gjendjes aktuale.

Me datën **26 dhe 27 Qershor** është mbajtur takimi i dytë i partnerëve të projektit në zyrat e ICK- STIKK në Prishtinë. Gjatë këtyre dy ditëve partnerët kanë diskutuar për zhvillimet në gjashtëmujorin e parë të projektit, dhe hapat e ardhshëm për mbarëvajtjen e projektit.

Trajnimi motivues për femra

Ne kuadër të projektit WomInnovation, me datën **18 Prill** STIKK organizoi një “Fjalim motivues” në të cilën morën pjesë shtatëmbëdhjetë ndërmarrëse potenciale – kryesisht studente të vitit të fundit në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Shkencave Kompjuterike (FIEK).

Ky takim ka pasur qëllim të motivojë ndërmarrëset potenciale të reja si dhe për ti njoftuar ato me mundësitë që do tu ofrohen përmes STIKK, projektit WomInnovation dhe ICK.

Gjatë këtij takimi znj. Vjollca Cavolli i ka motivuar studentet duke ndarë përvojat e saj, sfidat dhe sukseset gjatë karrierës së saj 26 vjeçare.

Si partner i projektit dhe rrjetit WomInnovation, STIKK ka organizuar një trajnim mbi shkathtësitë e komunikimit dhe prezantimit, e cila ka ardhur si kërkesë e takimit të parë ku shumica e studenteve kanë theksuar nevojën për një trajnim të këtillë.

Trajnimi u mbajt nga gazetari z. Gjergj Filipaj i cili ka ndarë me pjesëmarrëset disa këshilla lidhur me përhapjen e suksesshme të mesazhit, këshilla për prezantim dhe komunikim të mirëfilltë si dhe paraqitjen në media. Në trajnim kanë marrë pjesë gjithsej 7 absolvente të FIEK. Trajnimi është mbajtur të Premten me **15.06.2012** në zyrat e Innovation Center Kosovo.

Panairi i Karrierës

STIKK në bashkëpunim me OEAK (AMCHAM) me datë **8 Maj**, organizuan Panairin e Karrierës në Sallën e Rinisë, Sportit dhe Kulturës. Në këtë panair morën pjesë me shume se 20 kompani nga sektorë të ndryshëm duke e përfshirë edhe sektorin e TIK, me gjithsej 175 vende të lira pune. Gjatë këtij panairi kishte me shume se 600 kërkues pune, të cilëve iu dha rasti të njoftohen me kompanitë dhe me pozitën e hapura për punë.

Sipas fjalëve të kompanive pjesëmarrëse, secila prej tyre ka kontaktuar me mesatarisht 130 studenta për një ditë, ndërsa rreth 200 prej tyre u ftuan në intervistë pune.

Përgjithësisht organizimi i panairit ishte i mirë, e vetmja mangësi ishte mospregatitja adekuate e punëkerkuesve për të aplikuar.

STIKK vazhdon përkrahjen e sektorit të TIK në implementimin e standardeve (ISO 27001)

Në datat **25-29 Qershor**, STIKK me përkrahjen e GIZ organizoi “ISO 27001 Lead Implementer Trajnim dhe Certifikim”. Gjithsej 9 pjesëmarrës nga kompanitë anëtare të STIKK morën pjesë në këtë trajnim pesë ditor.

Ky trajnim intensiv pesë ditor u mundësoi pjesëmarrësve që të zhvillojnë ekspertizën e nevojshme për ta përkrahur një organizatë në implementimin dhe menaxhimin e ISMS (Information Security Management System) të bazuar në ISO/IEC 27001:2005. Pjesëmarrësit përfituan një njohuri të gjerë të praktikave të përdorura në implementimin e kontrolleve për siguri të informatave prej të gjitha zonave të ISO 27002. Ky trajnim ishte në përputhshmëri me praktikën e menaxhimit të projekteve të zhvilluara në ISO 10006 (Quality Management Systems – Udhërrëfyesi për Menaxhimin e Kualitetit në Projekte). Ky trajnim ishte poashtu kompatibil me ISO 27003 (Udhërrëfyes për implementimin e një ISMS), ISO 27004 (Matja e Sigurisë së Informacionit) dhe ISO 27005 (Menaxhimi i Riskut në Sigurinë e Informacionit).

Në ditën e fundit të këtij trajnimi u mbajt provimi certifikues ku 8 pjesëmarrës e kaluan me sukses.

Organizimi i trajnimit dhe certifikimit për Tester Softuerik

Gjatë periudhës 21-31 Gusht, 2012 STIKK organizoi trajnimin dhe certifikimin për “Tester Softuerik” në objektin e ICK-se. Në këtë trajnim ishin 15 pjesëmarrës, ndërsa ditën e fundit pjesëmarrësit iu nënshtruan provimit certifikues të cilën e kaluan 9 prej 15 pjesëmarrësve. Ky trajnim ka zgjuar interesim të madh tek anëtarët, prandaj po kërkohet mundësia që të përsëritet në të ardhmen.

STIKK me përkrahjen e GIZ organizuan trajnimin “Software Testing” i cili u mbajt me 21- 31, Gusht 2012 në Innovation Center Kosovo. 15 pjesëmarrës, pesë nga të cilët ishin femra, morën pjesë në këtë trajnim. Trajnimi zgjati 10 ditë dhe ishte i dizajnuar që të ofroj një bazë të shkëlqyeshme të njohurive dhe shkathtësive praktike në Testim të Softuerit dhe Teknikat e Menaxhimit të Testit. Trajnimi filloi me një kurs parapërgatitor që zgjati 5 ditë, 21 deri 25 Gusht, i cili kishte për qëllim parapërgatitjen e pjesëmarrësve për trajnim duke përfshirë informata të përgjithshme dhe kërkesat e certifikimit.

Pese ditët e ardhshme 27th-31st Gusht, përmbajtën një përmbledhje të Testimit të Softuerit duke përfshirë edhe diskutime mbi rëndësinë e testimit të Softuerit, nivelet e ndryshme të testimit dhe principet bazike të testimit. Pjesëmarrësit patën rastin të mësojnë teknika për të implementuar teste sistematike, "loop testing" dhe "basis path testing". Gjate këtij trajnimi u përfshinë edhe strategjitë për testimin e integritetit të softuerit dhe integritetin e sistemeve.

Ne ditën e 10te, 31 Gusht, u mbajt provimi certifikues "ISTQB Software Testing" nga i cili 9 nga 15 pjesëmarrës e kaluan me sukses. 11 pjesëmarrës ishin studentë të TIK dhe me përfundimin e këtij trajnimi u punësuan.

Takimi i hulumtuesve nga Kosova me hulumtuesit ndërkombëtar, Varshave

Gjatë takimit të muajit korrik në kuadër të projektit FP7/KOSEU, është identifikuar një mundësi për hulumtuesit nga Kosova të takohen me hulumtues ndërkombëtarë në ICT Proposers day me datën 26-27 Shtator 2012 në Varshavë. Njoftimi për këtë mundësi u është përcjellur të gjithë anëtarëve të STIKK si dhe Universiteteve. Prej gjithsej pesë kandidatëve të përzgjedhur si përfitues të grantit, një është tërhequr me vetedëshirë, ndërsa kandidati tjetër nuk ka mundur të udhëtojë në Varshavë për shkaqe shëndetësore.

Vizite studimore në Norvegji

Ne javën e dytë të Tetorit, partneret e programit HERD, përfaqësuesit e biznesit dhe universitetet nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia udhëtuan në Gjovik në një vizite pune. Qëllimi i vizitës ishte njoftimi me stafin akademik të Universitetit të Gjovikut, në të cilin dërgohen për çdo vit nga 20 studente nga tri vendet e sipërpërmendura. Përveç mundësisë për të parë ambientet e mësimi dhe rekreacionit në kuadër të kampusit të këtij universiteti, vizitorët patën rastin edhe të diskutojnë për kurrikula me mësimdhënësit e atjeshëm. Poashtu u organizua një takim me 10 studentet e parë që ishin vendosur dhe vijonin semestrin në këtë universitet. Obligimi i shoqatave të biznesit në kuadër të këtij projekti është që t'ju mundësojë kryerjen e praktikës këtyre studenteve në njërin nga kompanitë të TIK në shtetet përkatëse.

Një tjetër komponent i rëndësishëm i këtij udhëtimi ishin 50 studentët e universiteteve MAK të cilët do të kalonin një semestër në GUC. Tashmë, 10 prej këtyre studentëve kanë filluar këmbimin e semestrave ndërsa 4 të tjerë do të vazhdojnë studimet e tyre të doktoraturës në Universitetin e Gjovik-ut. Nga këta 10 studentë, 4 prej tyre janë nga Kosova ndërsa nga 3 nga Shqipëria e Maqedonia. Të gjithë studentët do të kryejnë praktikën e tyre në disa prej bizneseve norvegjeze për një periudhë të shkurtër në mënyrë që të fitojnë përvojë dhe të jenë më të përgatitur dhe tërheqës për industrinë e TIK në Kosovë.

Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria janë të përfshirë në këtë projekt përmes projektit Academic Exchange Program (AEP) e cila financohet nga Ministria e punëve të jashtme të Norvegjisë, ndërsa menaxhohet nga Athene Project Management.

Organizimi i trajnimit dhe certifikimit për ISO 9001

Gjatë periudhës 17-21 Dhjetor, 2012 STIKK organizoi trajnimin dhe certifikimin për ISO 9001 Lead Implementer në objektin e ICK-së. Në këtë trajnim ishin 12 pjesëmarrës, ndërsa ditën e fundit pjesëmarrësit i'u nënshtruan provimit certifikues.

STIKK me përkrahjen e GIZ organizuan trajnimin "ISO 9001 Lead Implementer" i cili u mbajt gjatë periudhës 17-21 Dhjetor, 2012 në Innovation Center Kosovo. Në këtë trajnim ishin 12 pjesëmarrës, gjashtë prej të cilëve ishin femra.

Trajnimi zgjati 5 ditë dhe trajtonte çështjet elementare lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë. Ky trajnim kishte për qëllim përgatitjen e pjesëmarrësve për përkufizimet e standardeve, krijimin e tyre si dhe rëndësinë dhe përfitimet që rezultojnë me përdorimin e këtij standardi.

Një nga temat bosht që është trajtuar në këtë trajnim është interpretimi i kërkesave të sistemit të menaxhimit sipas standardit ISO 9001:2000. Synimet e tij kanë qenë:

- Përfitimi i njohurive bazë me kërkesat që parashtron standardi ndërkombëtar ISO 9001:2000
- Mundësimi/lehtësimi i projektimit, zbatimit, kontrollit dhe përmirësimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë nëpërmjet zbërthimit dhe interpretimit të tyre në gjuhë praktike.

Në ditën e 5-të të trajnimit, më 21 Dhjetor, u mbajt provimi certifikues “ISO 9001 Lead Implementer”, i cili ishte mjaft i suksesshëm.

ICT KOSEU ofron mundësi për hulumtuesit përmes ueb faqes

Si pjesë e projektit ICT KOSEU, i cili ka për qëllim të lehtësojë pjesëmarrjen e hulumtuesve Kosovarë në programin FP7 ICT dhe të përkrahë përpjekjet e Kosovës për përfshirje në Zonën Evropiane të Hulumtimit ERA, është lansuar ueb faja e projekti e cila u ofron mundësi hulumtuesve dhe profesionistëve të regjistruar dhe të krijojnë profilin e tyre. Me këtë rast hulumtuesve vendorë u jepet mundësia të bëhen pjesë e bazës së të dhënave e cila do të jetë një burim i ekspertizës vendore.

Kjo databazë njëkohësisht do të krijojë mundësi bashkëpunimi me profesionistë dhe hulumtues të BE dhe krijojë mundësi për projekte të reja.

STIKK i është drejtuar të gjithë anëtarëve të saj me një email njoftues lidhur me këtë mundësi megjithatë përgjigjet kanë qenë në nivel të ulët.

Objektivi 3: Ofrimi i shërbimeve për anëtarë me qëllim të krijimit të mundësive të reja biznesore

Innovation Center Kosovo “Business Tuesday”

Me 24 Janar 2012, në mjediset e hotelit Sirius u mbajt ngjarja e pare e këtij lloji “Business Tuesday”

Kjo ngjarje është një forum për ndërmarrës dhe kompani të cilat synojnë mundësi të tregut, investitor, klient, zhvillim dhe mbi të gjitha rrjetëzim. Business Tuesday u organizua nga Qendra e Inovacionit e Kosovës (STIKK është një prej themeluesve) e cila është e orientuar në dialog të biznesit duke mbledhur përfaqësues të komunitetit publik dhe privat. Fokusi i kësaj ngjarje ishte trajnimi për programim në Android e cila ishte organizuar në bashkëpunim me programin KPEP të USAID.

BIZTECH

STIKK ishte partner përkrahës i konference BiZtech Roadshow, një konference e organizuar nga LEORON, e cila u mbajt në Prishtinë me datat 9-10, shkurt 2012. Tema e konferencës ishte Cloud Computing dhe prezantuesi kryesor ishte Ramses Gallego, një ekspert në Siguri me një ekspertizë të thellë në Menaxhim të Riskut. Gjate kësaj konference kishte kompani ekspozuese, të cilat patën rastin të promovojnë produktet, shërbimet dhe kompaninë e tyre.

CeBIT 2012

Gjate periudhës 6-10 mars 2012, STIKK së bashku me pesë kompani anëtare (Adaptivit, Rrota, Frakton, Logistics Plus and DataProgNet) morën pjesë në panairin me të madh në Evropë të TIK-ut, CeBIT 2012. Moto e këtij viti ishte “Kosovo: Your Outsourcing Destination”. Gjate këtyre pesë ditëve, kompanitë patën mundësinë të takohen me partner/investitor potencial, të promovojnë kompaninë e tyre dhe Sektorin e TIK-ut të Kosovës si destinacion adekuat për Outsourcing. Gjate ditëve të CeBIT-it, STIKK u takua me disa shoqata të TIK-ut duke përfshirë ANIS (Romanian Employers Association of the Software and Services Industry), CANIETI (Mexican Electronics Telecommunications & Information Technologies Industries Chamber), BASSCOM (Bulgarian Association of Software Companies), PIIT (The Polish Chamber of Information Technology and Telecommunications) dhe z. Santiago Gutierrez – Nenkryetar i Bordit të WITSA (World Information Technology and Service Alliance), ku STIKK promovoi anëtarët e saj, sektorin e TIK-ut të Kosovës dhe diskutoi mundësitë e bashkëpunimit me të ngushtë në të ardhme të afërt.

Gjate CeBIT 2012, znj. Mimoza Kusari-Lila, Zv. Kryeministre dhe Ministre, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë së bashku me z. Bernard Nikaj, Këshilltar i Lartë Politik dhe Shef i Kabinetit, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe z. Valdrin Lluka, CEO i Agjencisë për Promovim të Investimeve vizituan standin e Kosovës ku dhe shprehën gatishmërinë e tyre për të mbështetur zhvillimin e sektorit privat.

Konferenca Kosowwwweb

STIKK ne bashkëpunim me CEED Kosovo dhe Telegrafi organizuan konferencën “Kosowwwweb” me temën “Marketingu dhe Shitja Online”, e cila u mbajt me **4 Maj, 2012** ne Hotel Emerald.

Folësit kryesore te konferencës Kosowwwweb ishin Euan Semple, Marko Montemagno, Kushtrim Xhakli dhe Timotej Gala, te gjithë ekspert ne fushën e Marketingut dhe Shitjes Online.

Hapjen e konferencës e beri znj. Vjollca Cavolli, drejtoreshë ekzekutive e STIKK dhe z. Gent Lluka, CEO ne Telegrafi.

Konferenca kishte gjithsej 210 pjesëmarrës, prej te cilëve 150 ishin nga sektori I TIK.

Ngjarja rajonale e TIK ne Tirane (Regional IT Event in Tirana)

Me datën **18 Maj, 2012** STIKK mori pjese ne ngjarjen “**Regional IT B2B Event**” e cila u mbajt ne Tiranë, Shqipëri. Kjo ngjarje u organizua nga USAID RCI dhe u implementua nga SEGURA Partners LLC ne bashkëpunim me Shoqatën e IT ne Shqipëri-AITA dhe USAID Rritje Albania. Qëllimi i kësaj ngjarje ishte te adresoj problemet te lidhura me Sektorin e TIK ne rajon, dhe te propozoj/gjej zgjidhje për këto probleme.

Nder te tjera, disa prej temave qe u diskutuan ne këtë ngjarje ishin:

1. Rëndësia e standardeve dhe certifikimeve për konkureshmerinë ne rajon dhe ne bote
2. Zgjidhjet elektronike te suksesshme nga rajoni (Zgjidhjet e TIK-ut për sektorë te tjerë, eQeverisja, eShërbimet, etj.)
3. iGlobal dhe trendet rajonale te TIK
4. Qendrat e Inovacionit dhe Ekselencës – Tryeze e rrumbullaket dhe diskutime nga rajoni
5. TIK ne Edukim

Pjesemarrja ne CompuTEX, Taipei

Prej datave **5-9 Qershor, 2012**, STIKK se bashku me katër kompani anëtarë (Comtrade Computers, Elting, Komtel, Rrota) morën pjese ne panairin me te madh te TIK ne Azi, i cili u mbajt ne Taipei, Taiwan.

Gjate pjesëmarrjes se tyre ne COMPUTEX, kompanitë patën rastin te njihen me trendet botërore te TIK, te krijojnë kontakte te reja, te promovojnë kompanitë dhe shërbimet e tyre, dhe te promovojnë sektorin e TIK te Kosovës. Përveç vizitës ne COMPUTEX, pjesëmarrësit nga Ballkani Perëndimor patën rastin te shohin punën e “Institute for Information Industry”, si funksionon eQeverisja ne nivelin komunal (Qendra e kontrollit te trafikut ne Komunën e Taipei), si dhe vizituan disa kompani te mëdha te TIK (Mitec, Synnex Warehouse and Distribution Center, Gemtek)

Kjo vizite u organizua dhe u financua nga EBRD.

B2B Kosove – Bullgari

Gjate **20-21 Qershor 2012**, pese kompani nga Kosova (Adaptivit, Interadria, Phogen, Expik, Telegrafi dhe Smard) morën pjese ne takimin B2B me kompanitë Bullgare e cila u mbajt ne Sofje (Bullgari) dhe u organizua ne kuadër te projektit “Kosovo Economic Development through Quality and Networking” projekt i financuar nga Zyra e Unionit European ne Kosove. Projekti implementohet nga ESI CEE, BASSCOM, LTI dhe ICT Cluster Bulgaria, ndërsa ky takim u organizua ne bashkëpunim me STIKK.

Kjo ngjarje B2B kishte për qëllim te promovojë lidhjet biznesore ndërmjet Kosovës dhe Bullgarisë, si dhe te themelojë një platforme për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet kompanive nga Kosova dhe Bullgaria ne mënyre qe te rrisë rrejet ekzistuese te kompanive te TIK-ut; te rris nivelin e tregtisë në shërbimet dhe prodhimet e TI; te hulumtoje mundësitë për investime dhe zhvillimin e projekteve te përbashkëta.

Dita Mbarëkombëtare e TIK

Me **28 qershor 2012**, në mjediset e Inovacion Centre Kosovo, Prishtinë, u mbajt takimi Mbarëkombëtar i TIK, ku morën pjesë përfaqësues nga kompanitë private, komuniteti i profesionistëve si dhe organizata dhe donatorë të huaj, kryesisht të sektorit të Teknologjisë së Informacionit.

Për të vazhduar traditën, Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës - STIKK dhe Shoqata Shqiptare për Teknologji të Informacionit - AITA organizuan “Ditën Mbarëkombëtare të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, qëllimi kryesor i së cilës është njohja, forcimi dhe krijimi i një rrjeti profesional mbarëkombëtar në fushën e TIK, me qëllim që të promovohen tregjet e të tre vendeve, të forcohen raportet mes kompanive dhe të ndikohet drejtpërsëdrejti në zhvillimin e mëtejshëm të sektorit.

Gjatë këtij takimi kompanitë e pranishme patën rastin të takohen mes vete, dhe me përfaqësues institucionesh shtetërore dhe ndërkombëtare. Takimi u hap nga znj. Vjollca Çavolli, Drejtoresha ekzekutive e STIKK-ut, e cila iu dëshiroi mirëseardhje të pranishmëve dhe i falënderoi për pjesëmarrje në këtë aktivitet. Më pas, të pranishmëve ju drejtua z. Enver Doko, Kryetar i Bordit të STIKK, z. Dritan Mezini, Kryetar i bordit të AITA-s, Z. Frederik Syversen, IKT Norge si dhe, Znj. Astrid Green, Kryetare e Bordit të ICK. Mysafirëve me pas iu prezantua objekti i Qendrës së Inovacionit të Kosovës-ICK dhe mundësitë të cilat ajo i ofron.

Ky aktivitet i suksesshëm do të pasohet dhe nga aktivitete të ngjashme në të ardhmen e afërt, qëllimi i të cilave do të jetë konsolidimi, forcimi dhe zhvillimi i sektorit të Teknologjisë së Informacionit në vend dhe në rajon.

Në këtë takim morën pjesë mbi 50 pjesëmarrës, ndër ta përfaqësues nga bizneset nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia si dhe përfaqësues të ndryshëm nga organizatat donatore, përkrahëse të sektorit TIK.

Organizimi i Konferencës SFK’12

STIKK në bashkëpunim me FLOSK, IPKO Foundation si dhe me FIEK me datë **12 Gusht**, organizuan konferencën SFK’12 në fakultetin teknik të Universitetit të Prishtinës. Kjo konferencë tradicionale është e katërta me rradhë për free and open source software që ka të bëjë me zhvillimin e dijes, kulturës si dhe zgjerimin e kesaj rryme edhe në Prishtinë, Kosovë.

Ligjëratat kryesore u mbajtën në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Universitetit të Prishtinës më 8 dhe 9 shtator ndërsa më 7 dhe 10 shtator u mbajt punëtorja në UNICEF Innovations Lab.

Si konferenca me e madhe e këtij profili në rajon, SFK12 mbledhi folës nga shumë vende anembanë botës duke përfshirë: Bruce Perens/Një nga themeluesit e lëvizjes për kod burimor të hapur. Perens është pronar i një kompanie softueri si dhe programues kompjuteri. Perens është bashkë-themelues i Open Source Initiative (OSI); Andrew Betts/Zhvillues në PHP dhe JavaScript si dhe themelues i Assanka, tani pjesë e Financial Times; Prof.Dr.Frederik Questier/ Këshilltar akademik për projektet arsimore të TIK-ut në disa vende në zhvillim si dhe profesor në disa departamente në Vrije Universiteit, Bruksel; Flamur Mavraj/ Mavraj është zhvillues i aplikacioneve në ueb me PHP.

ICT Summit Euroasia-Bilisim Zirvesi’12

STIKK mori pjesë në ICT Summit Euroasia-Bilisim Zirvesi’12, i cili u mbajt në Stamboll prej **11-13 Shtator 2012**, ku kishte pjesëmarrës nga fusha e TIK si dhe profesionistë të bizneseve nga rajoni i Euroazisë së bashku me aktorët kryesor nga qeveria, sektori publik si dhe bizneset lokale turke. Në këtë samit furnizuesit dhe përdoruesit e shërbimeve dhe produkteve të TIK, qeveria, studiuesit si dhe akademikët realizuan takime ndër-kufitare, me qëllim që të kenë një rol në agjendën e teknologjisë globale. Tema kryesore e këtij samiti ishte “Next Step” ku informatat më të hollësishme për këtë temë mund të gjeni në www.ictsummiteurasia.com. Përfaqësues nga STIKK ishte z. Bardh Kadiu si dhe 6 kompani nga Kosova të profilit TIK (Adaptivit, Rea Commerce, Napair grup, Rrezeart Studio, WSOP, Computerttrade).

Konferenca KosICT

Më 27 Shtator në Hotelin Emerald, u mbajt konferenca KosICT, e organizuar nga STIKK. Në këtë konferencë folësit ishin te nivelit ndërkombëtar, rajonal dhe vendor. Gjithashtu, këtë vit KosICT ishte nikoqire e **SEE ICT Forum** (South East European ICT Forum Board Meeting) - një iniciativë e përbashkët e Shoqatave të TIK, Qendrave të Ekselencës dhe Inovacionit, dhe përfaqësuesve të biznesit nga rajoni i Evropës Juglindore.

Konferenca KosICT mbuloi temat në vijim: e-qeverisje (eGovernance), mediat sociale në zhvillimin e biznesit (Social Media in Business Development), zgjidhjet mobile (Mobile Solutions) dhe biznes modelet inovative (Innovative Business Models).

Mysafir dhe moderator i konferencës ishte z. Villu Arak, ish udhëheqësi i Skype dhe tash CEO i "General Specifics". Ndër folës tjerë të konferencës ishin Dr. Arvo Ott drejtor i "e-Governance Academy" në Estoni; z. Blaž Golob drejtor i "Centre for eGovernance Development" për Evropën Juglindore; Driart Elshani, drejtor i departamentit për E-qeverisje në MAP; Flamur Mripa, konsulent; z. Peter A. Bruck CEO në "Research Studios Austria"; Igor Skunca, CCO në HTTP pool; Valon Canhasi, konsulent; Bent Haakon, Athene projekt; Petar Svarc, Melon Mobile; Milot Shala, inxhinier softuerik; Goran Milanov, CIO në CenterMine; Berislav Lopac, konsulent; dhe Driton hapiu, CACTTUS. Sponsoret e kësaj ngjarjeje ishin: MAP, IPAK, CEED, PTK, IPKO Foundation, Microsoft, Altima, ndërsa mbështetës ishin: ICK, Frutomania, Emerald, HTTPPOOL, Frakton, Projectgrafics, VM3. Përkrahës media ishin: Telegrafi, Hallakate, Digjitale dhe PCWorld.

Vegëza e konferencës: www.kosict.com

B2B në kuadër të konferencës KosICT

Ky aktivitet u organizua nga STIKK në kuadër të konferencës, dhe u mbajt më 28 Shtator në zyrë të ICK-se. STIKK me anë të B2B synonte që të mundësojë kompanive kosovare dhe atyre të huaja kryesisht nga Bullgaria që të takohen. Prezent ishin 10 kompani nga Kosova (ALTIMA, Cacttus, Code-X, Creative Group, Gashi Comp, Ion Coders, math4Kids, Ice Clean, InterAdria, IPKO, EXPIK) si dhe 6 të tjera bullgare (BASSCOM, ICT Cluster, Smartcom, Telenova, CenterMine, General Specifics).

B2B Takimi me VISMA

Në kuadër të projektit GROWTH në dhjetor u organizua B2B takimi në mes të kompanive të Kosovës dhe të kompanisë nga Norvegjia "VISMA". Gjatë qëndrimit 2 ditë të përfaqësuesit të kompanisë z. Tore Hansen u organizuan 5 takime me kompani anëtare në STIKK (Asseco, 3CIS, Cacttus, Rrota, Appdec), të përzgjedhura nga vete kompania Wisma në bazë të kriterëve të qarkullimit vjetor, numrit të të punësuarve dhe përvojës në eksport të shërbimeve.

Z. Tore Hansen u nda i kënaqur nga takimet dhe vizita në Kosovë dhe shprehi bindjen e bashkëpunimit të mundshëm me tregun e Kosovës.

Business Tuesday

Më 4 Dhjetor, STIKK ishte pjesë e ngjarjes Business Tuesday tema e të cilit ishte Matchmaking. Gjatë kësaj ngjarjeje, STIKK mbajti një prezantim, ku prezantoi shërbimet e saj dhe aktivitetet në lidhje me Matchmaking.

STIKK përmes Wominnovation përkrahë punën e grave

Gjatë muajit Dhjetor një ndërmarrëse Norvegjeze Anne LINNE- NORSK ALPAKKA e cila merret me prodhimin e leshit të Alpakkave ka vizituar Kosovën me qëllim të identifikimit të femrave me aftësi për thurje dhe qëndisje. Qëllimi i kësaj ndërmarrëse është që të identifikojë disa gra me aftësi më të theksuara dhe t'i angazhojë ato në punën e saj.

Me këtë rast, STIKK si partnerë e projektit është angazhuar në identifikimin e këtyre femrave me aftësitë e cekura dhe ka caktuar takime. Si rrjedhojë e këtyre takimeve disa nga këto femra janë angazhuar në përgatitjen e mostrave të para për NORSK ALPAKKA. Ky lloj bashkëpunimi ishte edhe një ndër objektivat e parapara në kuadër të projektit Wominnovation.

Pyetësori për Kompanitë – Growth Program

Gjatë kësaj periudhe STIKK ka përpiluar pyetësorin për nevojat e kompanive për eksportimin e shërbimeve si dhe nevojave për rritjen e sektorit në përgjithësi.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe STIKK ka filluar takimet me kompanitë për plotësimin e këtij pyetësori. Deri tani janë përgjigjur 10 kompani dhe deri në fund të janarit do të vizitohen gjithsej 50 kompani.

Pjesëmarrja në ngjarjet e Microsoft

Në tetor të këtij viti stafi i STIKK-ut mori pjesë në konferencat rajonale të Microsoft-it ; “Microsoft Vizija” në Maqedoni dhe në “Microsoft Days” në Shqipëri. Gjatë këtyre takimeve u promovuan projektet dhe aktivitetet e STIKK-ut si dhe u diskutua me sipërmarrës të ri për veprimtarinë e ICK-së në Kosovë si dhe krijimin e mundësive të reja.

Microsoft Vizija Event

Më 24 dhe 25 Tetor STIKK mori pjesë në konferencën Microsoft Vizija e cila u mbajt në Alexander Palace në Shkup të Maqedonisë. Gjatë kësaj konference STIKK u takua me Z. Labinot Bytyqi, sipërmarrës i ri, i cili punon në Silicon Valey, SHBA. Gjate këtij takimi STIKK e informoi Z. Bytyqi për veprimtarinë e ICK-së në Kosovë dhe i shpjegoi rëndësinë e pjesëmarrjes së tij në takimet e të martave në mënyrë që të ndaj eksperiencën dhe idetë e tij me ne.

Microsoft Day Albania

STIKK mori pjesë në konferencën Microsoft Day Albania të organizuar në Shqipëri, Tiranë më 14 Nëntor. Gjatë konferencës pjesëmarrësve të STIKK iu dha mundësia të takoheshin me Z. Arsen Kurti, drejtor i Microsoft Albania, me të cilin biseduan rreth mundësisë së organizimit të Microsoft Imagine Cup në Kosovë nën mbështetjen e Microsoft Albania.

Objektivi 4: Krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme të STIKK-ut

Zhvendosja e STIKK në objektin e Innovation Centre Kosovo

Që nga data 23 Prill, STIKK u zhvendos në zyrë të reja, të cilat gjenden në objektin e Innovation Center Kosovo, në rrugën Rexhep Mala 28A, Prishtinë, përballë mensës së studenteve.

Zhvendosja e STIKK në këtë objekt, ofron hapësirë me të madhe për Stafin e STIKK si dhe për trajnime të ndryshme që STIKK organizon për Anëtarët e saj.

Vete prezenca fizike e STIKK në një objekt të tillë ofron mundësi të shumta zhvillimi, rrjetëzimi dhe ndikimi pozitiv tek donatorët dhe vendimmarrësit.

Ceremonia e hapjes së Innovation Centre Kosovo

Me datën **28 Qershor 2012** u bë hapja solemne e Qendrës së Inovacionit në Kosovë e cila do të mbështesë ndërmarrësinë, inovacionin dhe zhvillimin e bizneseve komerciale me fokus në Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit. Qendra do të mbështesë bizneset e reja të sapoformuara si dhe ato ekzistuese me potencial zhvillimor.

Kjo qendër është e themeluar nga Athene Prosjektledelse, nga Norvegjia dhe Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës, me partnerin kryesor bashkëpunues Crimson Capital LLC, dhe është e financuar nga Ministra e Punëve të Jashtme të Norvegjisë. Me këtë rast, ambasadori norvegjez z. Jan Braathu shprehu përkrahjen e vendit të tij dhe theksoi se ICK do të jetë një qendër ku do të nxitet konkurrenca, ekspertiza dhe inovacioni.

I pranishëm në këtë ngjarje ishte edhe Kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, i cili tha se kjo qendër inovative ka për qëllim të përkrahë ndërmarrësinë, inovacionet dhe zhvillimin e bizneseve përmes TIK. Ai gjithashtu potencoi se Qeveria e Republikës së Kosovës në kuadër të platformës së zhvillimit ekonomik e konsideron zhvillimin e burimeve njerëzore dhe sektorin privat si dy prioritetet strategjike, prandaj themelimi i ICK është në përputhje me prioritetet e Qeverisë dhe do ta ketë përkrahjen e plotë të saj. Kurse znj. Mimoza Kusari-Lila, Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Tregtisë dhe Industrisë tha se teknologjia e informacionit është esenciale

për reformat e të bërit biznes, e cila po ashtu theksoi se me anë të teknologjisë së informacionit bizneset kanë qasje më të lehtë dhe më të shpejt në dokumente.

Kryetarja e bordit të ICK-së znj. Astrid Green, nga Projekti Athene u shpreh se ICK do të kontribuojë në krijimin e vendeve të punës përmes trajnimeve dhe punëtorive praktike. Ndërsa Drejtoresha e STIKK, znj. Vjollca Cavolli theksoi se roli i shoqatës është të krijojë fillimisht vende të reja të punës, si dhe mundësi për të bërë biznes.

PMP Prep Course

Gjate periudhës 27 shkurt – 2 mars, Menaxheret e Projekteve të STIKK morën pjesë në trajnimin përgatitor për certifikim të PMP/CAPM (Project Management Professional/Certified Associate in Project Management).

Ky trajnim pëse ditë ishte intenziv, energjik dhe efektiv në përcjelljen e të gjitha informatave të nevojshme për të kaluar testin PMP apo CAPM. Trajnimi ishte i organizuar në forme të ligjërimit, të ushtrimeve grupore dhe individuale, rasteve studimore (case studies), duke krijuar një ambient argëtues.

Trajnimi për menaxhim të projekteve

Me datat 12-14 shkurt 2012, STIKK mori pjesë në trajnimin e titulluar “Managing Projects” i organizuar nga KITE (Kosovo Improvement through Education). Ky trajnim tre ditë ishte një mundësi e mirë për të përfituar njohuri në menaxhimin e projekteve në tërësi dhe me një theks të veçantë në planifikim, menaxhim të riskut, punë ekipore dhe mendim kritik.

Përdorimi i softuerit Quick Books për menaxhimin e financave

Që nga 1 janari 2012, STIKK filloi të përdorë softuerin Quick Books, një softuer i njohur ndërkombëtarisht për kontabilitet. Këtë softuer STIKK e pranoi si donacion nga njëri prej anëtarëve të saj (Melita & Partners).

Po ashtu kjo kompani organizoi një trajnim në të cilin STIKK mori pjesë. Me këtë trajnim STIKK përfitoi njohuri në menaxhimin e linjave të ndryshme buxhetore duke përfshi Donatorët, Anëtarët, Grantet, Të hyrat, Shpenzimet dhe Raportet financiare.

Kursi përgatitës për Teknik të Kontabilitetit

Gjate muajit shkurt 2012, zyrtarja administrative dhe financiare filloi të ndjek kursin përgatitor për certifikim të Teknikut për Kontabilitet, i cili organizohet nga ShKÇAK (Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës). Ky kurs do të ndihmojë zyrtarës administrative dhe financiare të jete me profesionale në mbledhjen, kontrollimin dhe analizimin e të dhënave financiare të STIKK.

Trajnimi 1 në 1

Gjate periudhës 14-16 mars, STIKK ishte nikoqir i ekspertit Frank Ferrara (paguar nga KITE) për të implementuar trajnimin 1 në 1 lidhur me çështje të ndryshme financiare.

Trajnimi për Monitorim dhe Evaluim

Gjate periudhës 19-21 Mars 2012, STIKK mori pjesë në trajnimin “Monitoring and Evaluation”, trajnim i organizuar nga SPARK i cili u mbajt në Shkup, Maqedoni. Ky trajnim përmbante teknikat dhe metodat e monitorimit, teknikat për evaluim të aktiviteteve, të projektit në tërësi dhe rëndësinë e tyre në sukses të projektit.

Auditimi i financave të STIKK

Gjate kësaj periudhe raportuese kompania audituese e pavarur “AB Audit”, e përzgjedhur nga anëtarët e STIKK në mbledhjen e fundit të Kuvendit, ka bërë auditimin e të gjitha transaksioneve dhe procedurave financiare të STIKK për periudhën 1 Janar - 31 Dhjetor 2011. Raporti ka treguar rregullsi në të gjitha aspektet e menaxhimit të mjeteve.

STIKK ne Innovation Centre Kosovo

Pas punës gati dyvjeçare për funksionalizimin e Innovation Centre Kosovo, STIKK ka nënshkruar dy marrëveshje me Athene:

Kontrata e pare ne vlere mujore prej 4166 euro (prej marsit 2012) ka te beje me punën e deritanishme te STIKK ne ICK, si dhe ne përfaqësimin e mëtutjeshëm, pjesëmarrjen ne mbledhjet e Bordit, ne komisione vlerësuese etj. Kontrata e dyte ne vlere mujore prej 3333 euro (prej shtatorit 2012) për zhvillimin e programit te rritjes (growth program), i cili ka për qellim zhvillimin e kompetencave te kompanive ekzistuese dhe rritjen e mundësive për eksport te produkteve dhe shërbimeve.

Workshop "Business Development Services"

Ne kuadër te projektit SPARK, organizuar nga Triodos Facet është mbajtur një workshop ne periudhën 4-7 Shtator, i cili kishte për qellim zhvillimin e shërbimeve te reja për kompanitë anëtare ne baze te nevojës se tyre, si dhe ngritjen e kapaciteteve për partneret e këtij projekti (STIKK, BSCK, FRACTAL, BCZ, dhe Universiteti i Mitrovicës).

Qëllimi i këtij trajnimi ishte qe ne fund te tij, pjesëmarrësit te jene ne gjendje te:

- Identifikojnë nevojat e klientëve (cilësinë)
- Vlerësimin e tregut për klientë (sasinë)
- Përpilimin dhe studimin e tregut te ndërmarrësve
- Zhvillimin e një strategjie për tregun e ndërmarrësve

Trajnimi ne MS Project

Trajnimi ne MS Project u mbajt më 19 dhe 26 Nëntor në AUK për 5 anëtarë të stafit të STIKK. Ky trajnim u mbajt me qëllim që të ofronte njohuri në menaxhimin e të gjitha fazave të zbatimit të projektit, duke filluar nga planifikimi, aktivitetet, monitorimi, vlerësimi, duke përfshirë edhe pjesën financiare dhe atë të raportimit.

Trajnimi në Microsoft Project do të ndihmojë menaxherët e projektit në mbikëqyrjen e të gjitha aktiviteteve të projektit, aftësitë teknike, qasje më të lehtë në informata, si dhe paraqitje më të mirë të të dhënave tek partnerët. Për më tepër në fund të trajnimit 5 anëtarët e stafit që ishin pjesëmarrës në trajnimin MS Project u certifikuan.

Publikimet**Depërtimi dhe përdorimi i internetit në Kosovë**

Gjate pjese publike te kuvendit te 4 te STIKK, u prezantua hulumtimi "Depërtimi dhe përdorimi i internetit në Kosovë". Ky hulumtim u be gjate tremujorit te fundit te vitit 2011, me anën e 385 pyetësorëve te realizuar ne 28 Komuna dhe 50 fshatra.

Hulumtimi tregon se shtrirja e internetit ne Kosove duke u bazuar ne shtëpi është 72.1% përderisa ne shtetet e BE është 73%. dhe shtrirja e internetit ne Kosove duke u bazuar ne shfrytëzues është 46.3% ndërsa ne Greqi është 46.2% dhe Bullgari është 47.8%. Për ta lexuar raportin e plote te këtij hulumtimi ju lutem përcillenit këtë vegëz [Depërtimi dhe përdorimi i internetit në Kosovë](#)

Standardizimi ne sektorin e TIK: Pengese apo përparësi?

Ne fund te muajit janar 2012, STIKK përfundoi një vështrim analitik mbi Standardet ne Sektorin e TIK-ut: Pengese apo Përparësi?

Ky dokument sjell një vështrim të situatës në sektorin e TIK-ut që duhet të rregullohet, opsionet për veprim, si dhe një sërë faktesh në favor të standardizimit të një shkalle më të lartë në sektorin e TIK-ut. Ky punim poashtu lokalizon me saktësi problemet dhe pengesat e mundshme në procesin e standardizimit si dhe mënyrën e duhur për t'i zvogëluar ato rezeqe. Përfitimet nga standardizimi vijnë si për zhvillimin e sektorit ashtu edhe për konsumuesit e blerësit. Nga ngritja e standardeve të cilësisë në sektorin e TIK-ut përftojnë kompanitë pasi që ua mundëson atyre që të shesin shërbimet e tyre më lehtë edhe jashtë Kosovës, qeveria dhe blerësit e tjerë institucional do të fitonin një vlerë më të madhe materiale falë kualitetit të ngritur, po ashtu rritet konkurrenca

në treg, ndërsa mundësia për punësimin e individëve të pajisur me certifikata ndërkombëtare përmirësohet automatikisht.

Për ta lexuar dokumentin e plote, ju lutem përcillen në këtë vegëz [Standardization in the ICT Sector](#).

Analiza e Prokurimit Publik për TIK për periudhën Janar 2010 - Qershor 2012

Qëllimi i këtij studimi është që të bëjë vlerësimin e ndikimit të institucioneve publike në tregun e TIK në Kosovë. Studimi përmban llogaritjen e shumës totale të shpenzuar nga buxheti i konsoliduar i Kosovës për pajisjet dhe shërbimet e TIK të prokuruar nga Institucionet publike, identifikimin e anulimit të tenderëve si dhe të fenomeneve të tjera. Për të arritur këto objektiva, STIKK ka angazhuar kompaninë IQ Consulting, e cila ka analizuar të dhënat e Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik, të cilët posedojnë një listë të të gjitha kontratave të prokurimit publik. Të gjithë tenderët në fushën e TIK janë vendosur në një databazë të veçantë dhe rezultatet nga kjo databazë janë të paraqitura në këtë raport. Ky raport mund të gjendet në këtë vegëz [Raporti](#).

Raporti i Auditimit Teknologjik në kuadër të Projektit të KE/FP7: ICTKOSEU

Në kuadër të projektit të EC FP7, ICT-KOSEU është përfunduar raporti Technological Audit i cili ka për qëllim të paraqes gjendjen aktuale dhe prioritetet e zhvillimit dhe hulumtimeve në lëmin e Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit (TIK) në Republikën e Kosovës. Si aktivitet vijues në kuadër të kësaj përpjekjeje STIKK si partnere e projektit do të organizojë një takim konsultativ me palët e interesit për të diskutuar gjetjet e këtij raporti. Raporti është përgatitur dhe postuar në ueb faqen e projektit www.ictkoseu.eu.

Stafi i STIKK

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2012, janë bërë disa ndryshime në stafin e STIKK:

Për shkak të vëllimit të shtuar të punëve, më 1 prill pas procedurave të selektimit, është pranuar në punë Znj. Argjira Mexhuani si Asistente për Administratë dhe Financa (fillimisht ka qenë praktikante për 3 muaj) dhe me 1 tetor Z. Valon Canhasi si menaxher i projektit Growth. Në cilësinë e praktikantit është pranuar Znj. Vesa Batalli me 8 nëntor.

Në vitin 2012, STIKK numëron 7 punëtorë me orar të plote dhe 1 praktikante. Gjate implementimit të aktiviteteve, STIKK ka angazhuar 8 konsulent të jashtëm.

Anëtarët e STIKK

Me 2012, janë anëtarësuar 8 Kompani të reja: Trokit, King ICT, Altima, Ion Coders, Informatika Computers, PTK, Next SEO, Phogen.

Pas lansimit të shërbimit të ri për anëtarësimin e anëtarëve individual, gjatë këtij viti janë anëtarësuar 23 Profesionist/e edhe 35 Student/e.

Po ashtu tani kemi si anëtarë bashkëpunues edhe 3 kolegje private: Iliria, Universum edhe Riinvest.

Pas revidimeve të kompanive anëtare, tani STIKK numëron 123 anëtarë (60 kompani, 23 profesionist, 35 studente dhe 5 institucione arsimore).

Gjatë vitit 2012, anëtarësinë e kanë paguar gjithsej 39 kompani anëtarë ose 65% nga numri i gjithëmbarshtëm, ndërsa sa i përket anëtarëve individual pagesa e anëtarësisë do të fillojë në vitin 2013.

TE HYRAT DHE SHPENZIMET

Te hyrat

Gjatë vitit 2012, të hyrat e STIKK ishin 258,242.29€ (81.6% me shume krahasuar me 142,152.84€ te vitit 2011), dhe atë nga 9 burime të mjetëve: Qeveria Norvegjeze përmes Crimson Capital, GIZ, WomInnovation, Anëtarët e STIKK (anëtarësia, participimi në trajnime dhe aktivitete tjera), HERD, SPARK, FP7, ICK, dhe Growth Programi. Detajet e të hyrave janë të prezantuara në tabelën e mëposhtme:

	STIKK	SPARK 2011	Growth Programme	SPARK 2012	WomInnovation	ICK	HERD/AEP	GIZ	FP7	Crimson Capital	TOTAL
Income											
Membership Fees	11,533.30	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	11,533.30
Other Income	1,198.67	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1,198.67
Program Income	37,401.86	5,254.92	5,126.34	40,046.26	3,069.94	35,721.08	7,500.00	42,962.50	26,054.37	34,158.25	237,295.52
Program Service Fees	1,164.80	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1,164.80
Training Fees	7,050.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	7,050.00
	58,348.63	5,254.92	5,126.34	40,046.26	3,069.94	35,721.08	7,500.00	42,962.50	26,054.37	34,158.25	258,242.29
Total Income	58,348.63	5,254.92	5,126.34	40,046.26	3,069.94	35,721.08	7,500.00	42,962.50	26,054.37	34,158.25	258,242.29

Shpenzimet

Gjatë periudhës raportuese, shpenzimet e STIKK arritën shumën prej 241,723.20€. Disa nga projektet nuk janë mbyllur këtë fundvit, pasi që edhe kontratat por edhe kohëzgjatja është e ndryshme. Pasqyra e shpenzimeve në detaje është e prezantuar në tabelën e mëposhtme:

	STIKK	SPARK 2011	Growth Programme	SPARK 2012	WomInnovation	ICK	HERD/AEP	GIZ	FP7	Crimson Capital	TOTAL
Expense											
Admin Costs/Operations	10,098.17	0.00	1,049.86	2,520.69	0.00	3,548.17	0.00	0.00	0.00	2,832.27	20,049.16
Capacity Building	10.00	2,360.60	0.00	2,996.40	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	590.00	5,957.00
Consultancy Expenses	3,607.63	0.00	0.00	0.00	0.00	3,184.19	0.00	0.00	0.00	10,829.87	17,621.69
Depreciation Expense	2,275.89	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	2,275.89
International travel & trans	3,726.94	0.00	69.49	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	3,665.93	7,462.36
International travel inc.par	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	600.49	600.49
Other Expenses	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	4,811.98	0.00	4,811.98
Profesional Services	648.00	0.00	0.00	0.00	0.00	2,000.00	0.00	0.00	0.00	1,450.00	4,098.00
Program Activities	3,000.00	2,894.32	0.00	6,860.50	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	12,754.82
Reconciliation Discrepancies	-0.02	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	-0.02
Regional ICT Matchmaking	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	8,646.80	8,646.80
Salary long term Local Staff	1,198.57	0.00	3,732.12	18,568.69	3,000.00	26,463.72	7,500.00	0.00	18,222.16	5,336.71	84,021.97
Training & Event expenses	-2,810.26	0.00	27.12	8,500.00	59.94	525.00	0.00	42,987.70	310.26	0.00	49,599.76
Travel & Transportation	112.58	0.00	47.75	599.98	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	15.83	776.14
Travel and Meetings	23,024.57	0.00	200.00	0.00	10.00	0.00	0.00	0.00	5,837.76	190.35	29,262.68
VAT on purchases	49.23	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	49.23
Total Expense	44,941.30	5,254.92	5,126.34	40,046.26	3,069.94	35,721.08	7,500.00	42,987.70	29,182.16	34,158.25	247,987.95
Net Surplus	13,407.33	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	-25.20	-3,127.79	0.00	10,254.34
Ending balance 31/12/2011	-168.36	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	-168.36
Net Balance 31/12/2012	13,238.97	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	-25.20	-3,127.79	0.00	10,085.98
Deferred income 2012/2013	0.00	678.08	8,205.66	7,283.27	1,430.06	5,942.92	0.00		0.00		23,539.99
Cash on bank on 31/12/2012											13,398.64
Cash on hand on 31/12/2012											1,338.30
Total cash											14,736.94
Payable tax											1,000.38
Pension Contributions											1,215.69

Mbledhjet e Bordit

Gjate vitit 2012 u mbajtën gjithsej shtatë mbledhje të Bordit të STIKK, katër të rregullta (30 janar, 10 maj, 03 Gusht dhe 18 Tetor) dhe tri të jashtëzakonshme (21 shkurt, 19 prill dhe 6 shtator).

Me 30 Janar, 2012, ne mbledhjen e njëzete te rregullt, ku janë diskutuar çështjet ne vijim:

- Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja paraprake e Bordit, e mbajtur me 20 tetor, 2011
- Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor tetor-dhjetor
- Diskutimi dhe aprovimi i raportit vjetor 2011
- Përgatitjet për mbledhjen e 4-te te Kuvendit te anëtarëve te STIKK
- Te ndryshme

Pas diskutimeve, Bordi mori vendimet ne vijim:

- Aprovohet procesverbali i mbledhjes se nëntëmbëdhjetë te mbajtur me 20 tetor
- Aprovohet raporti tremujor
- Aprovohet raporti vjetor 2011
- Aprovohet data tentative (29 shkurt) dhe rendi i ditës i Kuvendit te anëtarëve te STIKK

Me 21 Shkurt, 2012 ne mbledhjen e njëzetënjëtë (e jashtëzakonshme), ku janë diskutuar çështjet ne vijim:

- Diskutimi i draft rendit te ditës për Mbledhjen e katërt te Kuvendit te STIKK
- Te ndryshme

Pas diskutimeve, Bordi mori vendimet ne vijim:

- Aprovohen propozimet mbi listën e te ftuarve dhe finalizohet rendi i ditës për mbledhjen vjetore te Kuvendit
- Caktohet data finale e mbajtjes se mbledhjes se Kuvendit me 28 mars, 2012.

Me 19 Prill, 2012, ne mbledhjen e njëzete e dyte (e jashtëzakonshme), ku janë diskutuar çështjet ne vijim:

- Diskutim rreth qëndrimit zyrtar të STIKK lidhur me Innovation Centre Kosovo
- Të ndryshme

Ndër të ndryshme, u propozua kjo pikë:

- Vazhdimi i kontratës se drejtoreshës znj. Vjollca Cavolli
- Përzgjedhja e nënshkruesit financiar

Pas diskutimeve, Bordi mori vendimet ne vijim:

- Aprovohen te gjitha propozimet
- U aprovua dhe u autorizuan përfaqësuesit e STIKK te prezantojnë qëndrimet zyrtare dhe pakënaqesitë e Shoqatës ne mbledhjen e bordit te ICK

Ndërsa për pikën në të ndryshme, Bordi unanimisht vendosi që ti vazhdohet kontrata drejtoreshës ekzekutive, ndërsa ne mënyre unanime propozohet dhe zgjedhet znj. Zana Tabaku si nënshkrues i dyte financiar

Me 10 Maj, 2012 ne mbledhjen e njëzetetretë, ku janë diskutuar çështjet ne vijim:

- Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e njëzetënjtë e jashtëzakonshme.
- Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja njëzetedytë e jashtëzakonshme .
- Diskutim rreth aprovimit të raportit tremujor të STIKK.
- Diskutimi dhe aprovimi i Draft Rregullores së brendshme të STIKK.
- Të ndryshme

Pas diskutimeve, Bordi mori vendimet ne vijim:

- Aprovohet procesverbali nga mbledhja e njëzetënjtë e Bordit, e mbajtur më 21 Shkurt 2012.
- A provohet procesverbali nga mbledhja e njëzetedytë e Bordit, e mbajtur më 19 Prill 2012.
- Aprovohet njëzëri raporti tre mujor i STIKK
- U aprovua Rregullorja e brendshme e STIKK me korrigjim të disa neneve

Nën të ndryshme, Drejtoresha Ekzekutive i informoi të pranishmit rreth rrjedhës së punës së Qendrës Inovative të Kosovës, ndërsa z. Gezim Pula propozoi që mbledhjet e ardhshme të Bordit të mbahen neper kompanitë e anëtarëve të Bordit në mënyrë rotative, kështu që mbledhja e ardhshme e Bordit do të mbahet në zyrat e 3CIS-it.

Me 03 Gusht, 2012, ne mbledhjen e njëzetekatërtë, ku janë diskutuar çështjet ne vijim:

- Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e njëzetetretë, e mbajtur më 10 Maj 2012
- Diskutim dhe aprovimi i raportit tremujor të STIKK
- Të ndryshme

Ndër të ndryshme, u propozuan këto pika:

- Pagesa e anëtarësisë
- Aprovimi i rregullores së brendshme të STIKK
- Mundësia e themelimit të STIKK Angel Fund
- Pas diskutimeve, Bordi mori vendimet ne vijim:
- Aprovohet njëzëri raporti tremujor
- Aprovohet procesverbali nga mbledhja e njëzetetretë e Bordit, e mbajtur më 10 Maj 2012

Ndër të ndryshme: Bordi diskutoi lidhur me pagesat e anëtarësisë dhe vonesat dhe u vendos që STIKK t'ju dërgojë anëtarëve një email rikujtues për rifreskimin e listës së anëtarëve .

Anëtarët e Bordit u dakorduan që rregullorja për procedurat e funksionimit të brendshëm të shoqatës të ju dërgohet me postë elektronike për aprovim.

Sa i përket konceptit të STIKK Angel Fund të gjithë anëtarët e bordit u dakorduan që pas aprovimit nga ana e donatorit dhe para fillimit të implementimit të STIKK Angel Fund, të organizohet një takim i Bordit me z. Disha (autor i propozimit).

Me 06 Shtator, 2012 është mbajtur mbledhja e njëzetepestë (e jashtëzakonshme), ku janë diskutuar çështjet ne vijim:

- Diskutim rreth hartimit të strategjisë për promovimin e eksportit për industrinë e softuerit dhe të shërbimeve IT të Kosovës.

Pas diskutimeve, Bordi mori vendimin në vijim:

- Të përpilohet një pyetësor lidhur me nevojat e kompanive e cila do të ndihmojë në hartimin e strategjisë për promovimin e eksportit për industrinë e softuerit dhe të shërbimeve të IT të Kosovës.

Me 18 tetor, 2012, ne mbledhjen e njëzetegjashtë, ku janë diskutuar çështjet ne vijim:

- Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e njëzetekatërtë dhe nga mbledhja e njëzetepestë (e jashtëzakonshme) e Bordit të STIKK, mbajtur më 6 Shtator 2012
- Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor të STIKK
- Të ndryshme
 - Prezantim nga konsulenti z. Bersant Disha rreth STIKK Angel Fund
 - Prezantim i hulumtimit për Prokurimin Publik për periudhën Qershor 2009- 2012
 - Prezantim i punës së STIKK në ICK dhe nënshkrimi i kontratave
 - Prezantimi i draft pyetësorit

- Kërkesa për anëtarësim nga sektori bankar

Pas diskutimeve, Bordi mori vendimin në vijim:

- Aprovohet procesverbali nga mbledhja e njëzetekatërtë dhe njëzetepestë e Bordit, e mbajtur me **3 Gusht 2012** dhe **6 Shtator 2012**.
- Aprovohet njëzëri raporti tremujor.

Nen te ndryshme:

Pas prezantimit të konceptit të STIKK Angel Fund, Bordi ishte skeptik për të vendosur për të filluar implementimin e këtij instrumenti financiar. Për këtë arsye në fund u vendos që të kërkohet nga Recura të përpilojë një dokument të thuktë dhe të qarte deri në 2 faqe si dhe të hulumtohet për këtë çështje se si funksionon. Me pas tu dërgohet një sqarim se bashku me një pyetësor anëtareve të bordit të STIKK, ku me pas të votohet në Asamblenë e Kuvendit.

Gjithashtu nën te ndryshme u diskutuar rreth hulumtimit mbi Prokurimin Publik i cili përmban llogaritjen e shumës totale të shpenzuar nga buxheti i Kosovës për pajisjet dhe shërbimet e TIK të prokuruar nga Institucionet publike, identifikimin e anulimit të tenderëve, përsëritjen e tenderave si dhe të fenomeneve të tjera. Qëllimi kryesor i këtij projekti është avokimi dhe lobimi me qëllim të përmirësimit të procesit të prokurimit publik.

Nën këtë pikë të pranishmit u njoftuan rreth punës së STIKK në ICK, me ç'raste u informuan për nënshkrimin e një marrëveshjeje dhe dy kontratave: Marrëveshje partneriteti të një niveli me të lartë për disa aktivitete, gjithashtu të pranishmit u informuan se tani e tutje STIKK është e involvuar në të gjitha aktivitetet e punës së ICK-së. Kontrate tjetër që është nënshkruar ka të bëjë rreth themelimit, funksionimit, menaxhimit si dhe të operacionalizimit të ICK-së. Dhe kontrata e fundit ka të bëjë me një program të posaçëm që quhet "Growth Program", në këtë kontratë është paraparë një vend pune për të ndihmuar kompanitë ekzistuese të përgatiten për të eksportuar produktet dhe shërbimet e tyre.

Gjithashtu nën te ndryshme është prezantuar draft pyetësori për export dhe shërbime të tjera të ngjashme, i cili u është dërguar bordit edhe me email. Vërejtje pati nga z. Dardan Vokshi si dhe z. Mentor Sahiti të cilët menduan se pyetësori është shumë voluminoz. Si përfundim u vendos që grupi punues i caktuar në mbledhjen e mëhershme të mblidhen edhe një herë që ta inkorporojnë pyetjet e nevojshme dhe largimin e atyre të panevojshme nga ky draft pyetësor.

Dhe në fund bordi i STIKK u njoftua për kërkesën nga ana e bankave për anëtarësim në STIKK. Për këtë çështje Bordi vendosi që bankat mund të anëtarësohen si anëtar bashkëpunues në STIKK.

Përmbyllje

Viti 2012 karakterizohet me disa suksese të mëdha duke filluar nga themelimi i Qendrës së Inovacionit të Kosovës, organizimi i suksesshëm konferencës rajonale KosICT dhe futjen e pakos fiskale në fazën finale të saj (Parlament).

Ky vit karakterizohet edhe me rritjen si në numër të projekteve poashtu e dhe në numër të stafit të angazhuar. Janë realizuar më shumë se 60 aktivitete kundër objektivave të Planit Strategjik 2011-2013.

Në periudhën e ardhshme njëvjeçare, STIKK do të vazhdojë të angazhohet rreth krijimit të një ambienti më të favorshëm për kompanitë anëtare, ndërsa theks i posaçëm do të jepet ofrimit të mundësive për eksport të produkteve dhe shërbimeve si edhe çështjes së avancimit të edukimit dhe trajnimit të kuadrove profesionale për tregun e Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit.

Poashtu këtë vit jubilar (5 vjet) STIKK do të angazhohet në aktivitete që shënojnë këtë jubile.

Prishtinë,
Janar, 2013